

Data 09.04.2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime - Procedurë e Hapur - Prokurim me mjete elektronike

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Supervizion punimesh Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 1”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):): 71247000-1 “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit”

VLERA E FONDIT LIMIT: 15,178,524.63 (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet e katër pikë gjashtëdhjetë e tre) **Lekë, pa TVSH.**

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për vitin 2024 (*Shkresa e MIE nr. 1707/3 prot, datë 18.03.2024*).

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;
- e. Listën e Informacionit Konfidencial, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në *Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur – Shërbime - prokurim me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Gjithashtu, është përcaktuar jo më e vogël se vlera e kontratës për të rritur numrin e konkurrentëve në procedurë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, 2023** (*Bilancet të parqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009*), **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 40 % të vlerës** së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 41, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të Nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikëqyrje** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 *“Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016”.* Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1	Punime gjurmimi në tokë
2	NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
3	NP-5	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit
5	NS-6	Sinjalistika rrugore jondriçuese
6	NS-7	Barrierra dhe mbrojtje rrugore
7	NS-18	Punime topogjeodezike

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr. 943 datë 28.12.2016”* (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

Meqënëse kemi të bëjmë me Mbikqyrjen e punimeve në zbatim argumentojmë se:

Kategoritë e mësipërme janë përcaktuar në përputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit për objektin: “Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti I”. Gjithashtu, këto kategori licence bazohen edhe në projektin / Specifikimet teknike të punimeve të zbatimit për këtë objekt.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtoare minimalisht **6 (gjashtë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **Tetor 2023 - Mars 2024**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Tetor 2023 - Mars 2024**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Tetor 2023 - Mars 2024**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe Nenit 41 pika 4/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtoare të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: **për përcaktimin e fuqisë punëtoare minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas**

Termave të Referencës në preventivin “Supervizion punimesh Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 1”. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Tetor 2023 - Mars 2024 tregon besueshmëri për autoritetin.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbikëqyrës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1. Drejtuesin e projektit duhet të jetë Inxhinier Ndërtimi me licencë dhe me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, ndjek e miraton cilësinë e punimeve për veprat e artit nga pikëpamja strukturore; miraton materialet dhe volumet e punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korrespondencën me ARRSH.

2. Mbikëqyrësin për punimet topografike, që duhet të jetë Inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshajder me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili kontrollon dhe miraton volumet, piketimet dhe kuotëzimin e objektit.

3. Mbikëqyrësin (Gjeolog / Gjeoteknik), duhet të jetë Inxhinier Gjeolog me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili kontrollon bazamentin e punimeve të mbushjes, punimet gjatë gërmimit, hapjet dhe thellësinë e themeleve të veprave të artit.

4. Mbikëqyrësin për punimet e sinjalistikës e të sigurisë rrugore, i cili duhet të jetë Inxhinier Mekanik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë. Ai miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve të sinjalistikës horizontale e vertikale (të përkohshme dhe të përhershme), si dhe sigurinë rrugore, gjatë kryerjes së punimeve dhe pas tyre.

5. Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë inxhinier mjedisi me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.

6. Mbikëqyrësin për punimet e drenazhimit dhe mbrojtjes lumore, që duhet të jetë Inxhinier Hidroteknik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili ndjek e miraton cilësinë e

punimeve për drenazhimin e trupit dhe skarpateve të rrugës, veprave të vogla hidroteknike si dhe mbrojtjen lumore.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledëes të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Licencë për mbikëqyrje punimesh, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të Referencës, gjithashtu, argumentojme se zgjedhja e stafit të mbikëqyrjes është bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt preventivin e objektit: “Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 1”

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001:2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Certifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e zbatimit që do të mbikëqyret dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të përfshira në termat e referencës janë hartuar në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3 date 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimit nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.